



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/1260**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.d Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) sipas autorizimit të dates 30/01/2025, dhe draftimit të vendimit nga zyra ligjore e dates: 18/02.2025 në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE “G.S.G SH.P.K.”, kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Menaxhimi i mbeturinave” me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PRISHTINËS”, më 03/03/2025, mori këtë:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e “G.S.G SH.P.K”. me nr. 2024/1260, e datës 23/12/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Menaxhimi i mbeturinave”, me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PRISHTINËS”.
2. Përmirsohet Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Menaxhimi i mbeturinave”, me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PRISHTINËS”. AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

**Aprovatim**

***- Faktet dhe rrethanat procedurale -***

Me 18.11.2024, "KOMUNA E PRISHTINËS", në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Menaxhimi i mbeturinave" me nr.prokurimi: 616-24-11988-2-1-1.

Autoriteti Kontraktues në këtë rast ka zhvilluar procedurë të hapur të prokurimit lloji i kontratës shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 16,500,000.00 €..

Me 09.12.2024, OE "G.S.G SH.P.K." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 18.12.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 23/12/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "G.S.G SH.P.K.", me nr. 2024/1260 lidhur me aktivitetin "Menaxhimi i mbeturinave" me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1.

***-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-***

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "G.S.G SH.P.K.", janë parashtruar si në vijim:

Edhe pas vendimit si e pabazur kerkesa per rishqyrtim e parashtruar me date 09.12.2024 nga ana e OE "GSG" SH.P.K per disa kerkesa te vendosura ne dosjen e tenderit, OE "GSG" sh.p.k., konsideron se AK KKP me Njoftimin për kontratë, me dokumentet e kërkuara me dosjen e tenderit dhe me vet dosjen e publikuar të tenderit në fjalë ka përcaktuar disa kritere diskriminuese dhe kufizuese të cilat krijojnë pozitë jo të barabartë të Operatorëve Ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit, kufizojnë mundësinë e tyre për të tenderuar në mënyrë të padrejtë dhe vështirësojnë në mënyrë të jashtëzakonshme mundësinë për të ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit. Andaj, OE "GSG"sh.p.k., e kundërshton Njoftimin për Kontratë, Dokumentet e tenderit dhe Dosjen e Tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Menaxhimi i Mbeturinave" dhe me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1 dhe me numër të brendshëm 616-24-230-2-1-1 dhe të njëjtat i konteston dhe kërkon ndryshimin e tyre dhe kjo për arsyet si në vijim

Fillimisht, ne si operator ekonomik nuk pajtohemi me kriterin e vendosur nga AK KKP te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, 9.1&9.2, kërkesa nr. 4, ku si kërkesë është

përcaktuar:

1.Kerkesa AK: · Lotet 1, 2 dhe 3 -të gjithë kamionët e mbeturinave të jenë të pajisur me një sistem të avancuar identifikimi (idenSystem) të integruar në pjesën e pasme të kamionit. Ky sistem duhet të bëjë leximin e qipave RFID të cilët janë të vendosur në kontejnerët e mbeturinave. I gjithë ky sistem duhet të jetë i lidhur me internet në mënyrë që të dhënat e zbrazjeve të përcillen në kohë reale në Softëarin C-Trace të cilin e posedon Komuna e Prishtinës, ose ndonjë softëare të ngjajshëm që e kryen funksionin e njëjt. Ndërsa si dëshmi dokumentare për këtë kërkesë është përcaktuar.

Një deklaratë të nënshkruar nga OE me dëshmi që i posedon paisjet e kërkuara ose në rast se OE ja nuk posedon pajisjet mbi pronësinë atëherë OE-ja duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Gjithashtu OE është i obliguar që pajisjet ti ketë në vendpunishte të vet, brenda në Kosovë, ku Autoriteti Kontraktues, komisioni i vlerësimit e bënë verifikimin e pajisjeve të prezantuara në listën e pajisjeve. OE 72 orë më herët njoftohet zyrtarisht lidhur me vizitën në teren nga ana e komisionit.

1.Kerkesa OE:

Ne si operator ekonomik kundërshtojmë kërkesën që verifikimi i pajisjeve të bëhet gjatë bazës së vlerësimit të dosjes së tenderit, pasi kjo kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe bie ndesh me kriterin që lejon prezantimin e marrëveshjeve për qira. Operatorët që planifikojnë të marrin pajisjet me qira i sigurojnë ato pas shpalljes së fituesit, duke shmangur kostot e panevojshme. Si rezultat, kjo kërkesë diskriminon operatorët që nuk i kanë pajisjet në pronësi dhe pamundëson dorëzimin e ofertave të tyre.

Për AK KKP duhet të jetë e mjaftueshme fakti që një operator ekonomik dorëzon dëshmi se posedon këto pajisje ose dëshmi se ka të nënshkruar marrëveshje të qirasë, sepse siç edhe vet AK KKP është në dijeni që operatorët ekonomik do të dorëzojnë garancionin për ekzekutimin e kontratës, andaj nëse pasi që një operator ekonomik e fiton tenderin dhe nuk i posedon këto pajisje, i njëjti do ta ketë të pamundur ta përmbushë kontratën dhe kështu automatikisht do ti konfiskohet garancioni për sigurimin e ekzekutimit të tenderit dhe kështu i dëmtuar do të përfundoj operatori ekonomik. Kjo edhe është një dëshmi se asnjë operator ekonomik nuk do të kishte interes të prezantonte dokumente që i posedon këto pajisje pa qenë i sigurtë se me të vertetë i posedon.

Andaj, rekomandimi ynë është që të ndryshohet ky kriter ashtu që të përcaktohet se verifikimi i pajisjeve në fjalë do të bëhet pas përzgjedhje së operatorit fitues dhe jo gjatë fazës së vlerësimit të tenderit. Kjo do të mundësoj që sa më shumë operator ekonomik të dorëzojnë ofertat e tyre dhe kështu të rritet konkurrenca, e që me rritjen e konkurrencës do të mundësohet që operatorët ekonomik të dorëzojnë ofertat e tyre me çmime më të ulta dhe kështu kjo do të jetë në dobi të buxhetit të Komunes së Prishtinës.

Kriter tjetër diskriminues me të cilin nuk pajtohem është edhe te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, 9.1&9.2, kërkesa nr. 6 ku është kërkuar:

#### 2.Kerkesa AK:

Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme dhe të obligueshme për realizimin e projektit sipas Aneksit 7. OE është i obliguar që pajisjet e prezentuara në listën e pajisjeve të ketë në vendpunishte të vet, brenda në Kosovë, ku Autoriteti Kontraktues, komisioni i vlerësimit e bënë verifikimin e pajisjeve të prezantuar në listën e pajisjeve. OE 72 orë më herët njoftohet zyrtarisht lidhur me vizitën në teren nga ana e komisionit.

Të dorëzohen dëshmia mbi pronësinë ose në rast se OE-ja nuk posedon pajisjet mbi pronësinë atëherë OE-ja duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët.

#### 2.Kerkesa OE:

Konsiderojmë se kjo kërkesë bazuar edhe ne Nenin 71 LPP, si edhe kërkesa nr. 4 e përmendur më lart, është diskriminuese dhe zvogëlon konkurrencën në dëm të operatorëve që i marrin pajisjet me qira ose janë të huaj. Nuk është e arsyeshme që pajisjet të kërkohen në vendpunishte para fitimit të tenderit, kur sigurimi i tenderit garanton realizimin e kontratës dhe ndëshkon moszbatimin. Kjo favorizon operatorët me pajisje në pronësi, zvogëlon konkurrencën dhe lejon abuzim me çmime të larta të ofertës. Kriter tjetër diskriminues me të cilin nuk pajtohem është edhe kërkesa te Aneksi 7.

#### 3.Kerkesa AK:

Pajisjet dhe Mekanizmi i Obligueshëm dhe Afati për KRYERJEN E Punimeve, ku për LOTO1, LOTO 2, LOTO 3, është kërkuar që niveli i emetimit të gazrave të jetë Euro 6 (apo teknologji më e avancuar se Euro6) dhe Euro 3 (apo teknologji më e avancuar se Euro3) dhe LOTO 4, LOTO 5,LOTO 6, është kërkuar që niveli i emetimit të gazrave të jetë Euro 4 (apo teknologji më e avancuar se Euro 4), Euro 3 (apo teknologji më e avancuar se Euro3).

#### 3.Kerkesa OE:

Ne si operator ekonomik konsiderojmë se ky kriter është diskriminues sepse në këtë aktivitet të prokurimit nuk kemi të bëjmë me furnizim, respektivisht blerje të kamionëve nga Komuna e Prishtinës, por kemi të bëjmë me kontratë për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave, e që nënkupton se ky proces mund të kryhet me cilindo kamion i cili është zhdoganuar nga Doganat e Kosovës dhe është regjistruar nga Agjencia për Regjistrimin e Automjeteve. Përderisa kamionët janë të regjistruar në Kosovë, kjo nënkupton se qarkullimi i tyre nuk mund të ndalet dhe çfarëdo vendimi ndryshe, në këtë rast cilado kërkesë ndryshe e dosjes së tenderit do ishte në kundërshtim me Ligjin për Automjete nr. 05/L-132. Me asnjë dispozitë ligjore të legjislacionit në

fuqi nuk është përcaktuar se ndalohet qarkullimi i kamionëve të cilët nuk kanë nivel të emetimit të gazrave Euro 6, Euro4 apo Euro 3.

Andaj, konsiderojmë se edhe kjo kërkesë si e tillë është diskriminuese në favor të operatorëve ekonomik që i kanë në pronësi këto pajisje dhe në dëm të operatorëve ekonomik të cilët i marrin këto pajisje me qira, e që kjo zvogëlon konkurrencën dhe i mundëson operatorit ekonomik që i ka në pronësi këto pajisje me emetim të gazrave Euro3, Euro4 dhe Euro 6 të abuzoj me çmime të ofertës duke ofertuar me çmime marramendëse të larta. Rrjedhimisht, propozojmë që kërkesa që këta kamion të jenë me nivel të emetimit të gazrave Euro 3, Euro4 dhe Euro 6 të largohet/fshihet në tërësi.

Shkelja e Ligjit për Prokurimin Publik përmes Kriterëve Diskriminues në Dosjen e Tenderit.

Konsiderojmë se të gjitha kërkesat/kriteret e Dosjes së Tenderit të cilat po i kundërshtojmë me këtë ankese, shkelin dispozitën e nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, sepse janë në tërësi diskriminuese.

Kjo kërkesë e dosjes së tenderit përbën shkelje të nenit 7 paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, ku përcaktohet se citojme:

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasisë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për

përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.

5. Po ashtu këto kritere janë përcaktuar në kundërshtim edhe me nenin 69 paragrafi 4 nënparagrafi 4.5 të LPP-së, ku është përcaktuar se Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë vetëm raportin mbi mjetet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve, por jo edhe të përcaktoj se verifikimi i mjeteve dhe pajisjeve do të bëhet në procedurë të vlerësimit të tenderëve nga ana e Komisionit Vlerësues, citojmë:

4. Në procedurat që shpjen në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkojnë lidhur me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë. Të dhënat përkitazi me aftësitë teknike të operatorëve ekonomik mund të parashtrihen përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të shërbimeve që duhet të furnizohen:

4.5. raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "G.S.G SH.P.K.", konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelir nenin 1,6, 7, 11, 61, 72 i LPP-se. Andaj, si përfundim OE "GSG: sh.p.k., i propozon OSHP-se, që pas shqyrtimit të kësaj ankese të marrë këtë: VENDIM te APROVOHET ankesa e Operatorit Ekonomik "GSG" sh.p.k., e parashtruar kundër Njoftimit për Kontratë të datës 18.11.2024\_, Dokumenteve të tenderit dhe Dosjes së Tenderit për Kontratën Publike Kornizë Shërbim, në aktivitetin e prokurimit me titull Menaxhimi i Mbeturinave me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1 dhe numër të brendshëm 616-24-230-2-1-1, për LOTO 1, LOTO 2, LOTO 3, LOTO4, LOTO 5, LOTO 6. NDRYSHOHET Njoftimi për Kontratë i datës 18.11.2024\_, Dokumentet e tenderit dhe Dosja e Tenderit për Kontratën Publike Kornizë Shërbim, në aktivitetin e prokurimit me titull Menaxhimi i Mbeturinave me numër të prokurimit 616-24-11988-2-1-1 dhe numër të brendshëm 616-24-230-2-1-1, për LOTO 1, LOTO 2, LOTO 3, LOTO4, LOTO 5, LOTO 6, ashtu që Organi Shqyrtues i Prokurimit vendos si në vijim: FSHIHET apo LARGOHET kriteri/kërkesa e përcaktuar në , 9.1&9.2, kërkesa numër 4 dhe kërkesa numer 6, ku si kërkesë— dëshmi dokumentare është përcaktuar: Gjithashtu OE është i obliguar që mjetet dhe pajisjet të ketë në vend punishte të vet, brenda në Kosovë, ku Autoriteti Kontraktues, Komisioni i Vlerësimit bën verifikimin e pajisjeve të prezantuara në listën e pajisjeve. OE 72 Orë më herët njoftohet zyrtarisht lidhur me vizitën në teren nga ana e Komisionit.

Pra të fshihet kriteri apo kërkesa ku kërkohet që këto mjete dhe pajisje OE ti ketë në vend punishten e vet, brenda në Kosovë dhe ku përcaktohet se Autoriteti Kontraktues, Komisioni i vlerësimit bën verifikimin e pajisjeve të prezantuara në listën e pajisjeve dhe atë me një njoftim prej 72 orë më herët për vizitën në teren nga ana e Komisionit. Maksimalisht propozojmë që si kriter të vendoset kriteri që verifikimi i pajisjeve të bëhet pasi që operatori ekonomik të shpallet ffitues. FSHIHET apo LARGOHET kriteri/kërkesa e përcaktuar në pjesën e dosjes së tenderit të Aneksi 7. Pajisjet dhe Mekanizmi i Obligueshëm dhe Afati për kryerjen e punimeve, ku për LOTO1, LOTO 2, LOTO 3, LOTO 4, LOTO 5, LOTO 6 për të gjithë kamionët/automjetet për të gjitha këto Lote, është kërkuar që niveli i emetimit të gazrave të jetë Euro 6 (apo teknologji më e avancuar se Euro 6), Euro 4 (apo teknologji më e avancuar se Euro 4), Euro 3 (apo teknologji më e avancuar se Euro 3)..Pra, të fshihet kriteri apo kërkesa që kamionët për këto Lote si më lartë të jenë të pajisur me emetim të gazrave Euro 3,Euro 4 ose Euro 6, ashtu që kërkesa për nivelin e emetimit të gazrave të fshihet në tërësi

Përgjigje e Autortitetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim: Përgjigjet e njësisë kërkuese lidhur me pretendimet ankimore janë prezantuar si në vijim: "Për të pasur sa më të thjeshtë OE-lë e interesuara në këtë aktivitet të prokurimit, si kërkesë kemi mundësuar dhe marrjen me qëra të pajisjeve. Megjithatë ne e kemi të domosdoshme të verifikojmë funksionimin e plotë të tyre, pasi që si Autoritet Kontraktues përmes këtij aktiviteti i ofrojmë shërbim të gjitha bizneseve dhe qytetarëve që operojn dhe jetojnë në qytetin ton. Gjithashtu edhe ngarkimi i disa bizneseve realizohet përmes numrit të zbrdzyeve të kontejnerëve. Andaj nësejo në të gjithë kamionët (për rastin kur OE nuk i posedon kamionët) të paktën në një kamion duhet të ketë të vendosur sistemi për leximin e RFID-ve i cili është i lidhur me një softmare të ngjashëm me C-Trace. Verifikimi i pajisjeve do të jetë gjithashtu i domosdoshëm pasi që si Autoritet Kontraktues i ofrojmë shërbim të gjitha bizneseve dhe qytetarëve që operojnë dhe jetojnë në qytetin ton dhe ky shërbim është shërbim esencial. Standardi Euro6, Euro4 dhe Euro3 për kamionët që ofrojnëshërbim është shumë i rëndësishëm dhe njëkohësisht është hap i domosdoshëm për arritjen e objektivave tona si kryeqytet, për uljen e ndotjes së ajrit, i cili vazhdon të ketë shifra shumë të larta.

Por, ky nuk është hapi i vetëm i yni si Autoritet Kontraktues, të cilin e marrim në këtë drejtim, sepse përveç kamionëve të mbeturinave, kemi bërë hapa shumë të mëdhenj edhe në trafikun urban dhe shërbimet e tjera. Të gjitha këto veprimejanë ndërmarrë bazuar në "Planin Lokal për Cilësinë e Ajrit", të cilin e kemi hartuar ne si kryeqytet". >

Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese. Në këtë mënyrë është konstatuar që verifikimi i pajisjeve në punishte nga komisioni gjatë fazës së vlerësimit jo vetëm që është e domosdoshme por është e drejtë ligjore e garantuar e komisionit në kuptim të nenit 59 të LPP lidhur me nenin 39 të RRPP. Për këtë arsye pretendimi ankimor nr. 1 është i pabazuar. Në anën tjetër kamionët e kërkuar me standardin euro 3, euro 4 dhe euro 6 janë të domosdoshëm për menaxhimin e mbeturinave duke garantuar mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe ambientit. Prandaj edhe pretendimi ankimor nr. 2 është i pabazuar. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të

qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 27.12.2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1260/2024, ndërsa me datë 02.01.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/1260 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, "Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë përgjigje rreth raportit të ekspertit shqyrtues. Ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

#### ***- Administrimi dhe vlerësimi i provave –***

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "G.S.G SH.P.K.", eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1260 ka vlerësuar si në vijim:

#### **PËRSHKRIMI I ANKESËS**

Ankesa lidhet me pretendimet e parashtruara nga Operator Ekonomik "GSG" SH.P.K., kundër kriterëve të vendosura nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit "Menaxhimi i Mbeturinave". Konkretisht, kundërshtohen kërkesat të cilat kanë të bëjnë me kriteret e vendosura në Dosjen e Tenderit (FDT) dhe kërkesat e vendosura në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.

#### **ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES**

Pretendimi i parë: Verifikimi i pajisjeve gjatë fazës së vlerësimit



Pretendimi lidhet me kërkesën që pajisjet të jenë në vendpunishte dhe të verifikohen gjatë fazës së vlerësimit të tenderëve. OE konsideron këtë kërkesë si kufizuese dhe diskriminuese, pasi favorizon operatorët që tashmë i kanë pajisjet në pronësi dhe pengon ata që planifikojnë të sigurojnë pajisjet përmes marrëveshjeve për qira.

AK ka kërkuar si në vijim:

4. LLOTOT 1, 2 dhe 3 –të gjithë kamionët e mbeturinave të jenë të pajisur me një sistem të avancuar identifikimi (idenSystem) të integruar në pjesën e pasme të kamionit. Ky sistem duhet të bëjë leximin e qipave RFID të cilët janë të vendosur në kontejnerët e mbeturinave. I gjithë ky sistem duhet të jetë i lidhur me internet në mënyrë që të dhënat e zbrazjeve të përcillen në kohë reale në Softwarin C-Trace të cilin e posedon Komuna e Prishtinës, ose ndonjë softuerë të ngjashëm që e kryen funksionin e njëjte.

4. Një deklaratë të nënshkruar nga OE me dëshmi që i posedon pajisjet e kërkuara ose në rast se OE-ja nuk posedon pajisjet mbi pronësinë atëherë OE-ja duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Gjithashtu OE është i obliguar që pajisjet të ketë në vend punishte të vet, brenda në Kosovë, ku Autoriteti Kontraktues, komisioni i vlerësimit e bënë verifikimin e pajisjeve të prezantuara në listën e pajisjeve. OE 72 orë më herët njoftohet zyrtarisht lidhur me vizitën në teren nga ana e komisionit.

Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se, vendosja e kriterëve të vlerësimit është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e Autoritetit Kontraktues siç përcaktohet nga Neni 52.4 të LPP-së por nuk duhet të kenë në asnjë rast efektin e dhënies së një lirie të pakufizuar sipas zgjedhjes së autoritetit kontraktues

Pas analizimit të pretendimeve ankimore në proporcion me legjislacionin në fuqi eksperti shqyrtues vlerëson se Ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 7.1 dhe 7.6 garanton trajtim të barabartë të OE-ve dhe ndalon kufizimin e konkurrencës. Kërkesat aktuale favorizojnë operatorët që tashmë i kanë pajisjet dhe diskriminojnë ata që planifikojnë të marrin pajisje me qira.

Gjithashtu neni 69.4.5. thekson se AK mund të kërkojë raport mbi pajisjet teknike, por nuk parashikon detyrimin për prezencën e tyre fizike gjatë fazës së vlerësimit.

Kërkesat aktuale janë të tepërta dhe krijojnë barriera të panevojshme. Vendosja e kriterëve të tilla rrit kostot dhe pengon pjesëmarrjen e OE-ve që planifikojnë të marrin pajisje me qira..

AK duhet të pranojë deklaratat dhe dokumente tjera që tregojnë se OE do të sigurojë pajisjet pas shpalljes si fitues. Për më tepër, për të mbrojtur interesat në ekzekutim të kontratës, AK-së ka kërkuar sigurimi i ekzekutimit prej 10 % për të gjitha Lot-et në kohëzgjatje prej 37 muaj, i cili garanton që OE fitues do të përmbushë të gjitha detyrimet kontraktuale.

Kërkesa e AK-së për prezencën fizike të pajisjeve në fazën e vlerësimit është disproporcionale dhe diskriminuese, duke kufizuar pjesëmarrjen e OE-ve që planifikojnë të sigurojnë pajisjet

përmes marrëveshjeve të qirasë. AK-ja duhet të modifikojë kërkesën, duke pranuar marrëveshjet e qirasë ose dëshmitë e tjera të përshtatshme për të garantuar sigurimin e pajisjeve pas përzgjedhjes së fituesit. Verifikimi fizik i pajisjeve mund të bëhet vetëm pas dhënies së kontratës, duke minimizuar pengesat për konkurrencën.

Pretendimi i dytë: Pronësia dhe lokacioni i pajisjeve

Kërkesa që pajisjet të jenë të pranishme në vend punishte në Kosovë gjatë fazës së vlerësimit është cilësuar nga Operatori Ekonomik (OE) si diskriminuese dhe kufizuese. Kjo kërkesë favorizon operatorët lokal dhe dëmton operatorët e huaj dhe ata që planifikojnë të marrin pajisjet me qira dhe rrit koston e tyre financiare.

AK ka kërkuar si në vijim:

6. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme dhe të obligueshme për realizimin e projektit sipas Aneksit 7. OE është i obliguar që pajisjet e prezantuara në listën e pajisjeve të ketë në vendpunishte të vet, brenda në Kosovë, ku Autoriteti Kontraktues, komisioni i vlerësimit e bënë verifikimin e pajisjeve të prezantuara në listën e pajisjeve. OE 72 orë më herët njoftohet zyrtarisht lidhur me vizitën në teren nga ana e komisionit.

6. Të dorëzohen dëshmia mbi pronësinë ose në rast se OE-ja nuk posedon pajisjet mbi pronësinë atëherë OE-ja duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jete në emër të këtij projekti e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.

Eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa për prani fizike të pajisjeve në Kosovë kufizon pjesëmarrjen e operatorëve të huaj dhe rrit barrierat për ata që planifikojnë të marrin pajisje me qira. Ky kufizim jo vetëm që rrit koston dhe kompleksitetin e ofertave, por gjithashtu cenon konkurrencën e drejtë midis operatorëve ekonomikë.

Detyrimi i AK-së që pajisjet të jenë në vend punishte në Kosovë gjatë fazës së vlerësimit shkel parimet themelore të Nenit 7, i cili ndalon krijimin e kushteve që kufizojnë pjesëmarrjen dhe imponimin e kërkesave që nuk lidhen drejtpërdrejt me realizimin e kontratës.

Kjo praktikë diskriminon operatorët që marrin pajisje me qira ose janë të huaj, duke favorizuar operatorët lokalë.

Kufizimet mbi pronësinë dhe lokacionin e pajisjeve janë në kundërshtim me Nenin 71 të LPP-së, i cili kërkon që kërkesat të jenë proporcionale dhe të aplikohen për grupet si tërësi. Kërkesa për prani fizike të pajisjeve para shpalljes së fituesit imponon kushte të panevojshme që dëmtojnë konkurrencën.

OE-te që planifikojnë të marrin pajisje me qira janë të detyruar të përballojnë kosto shtesë për të siguruar prani fizike në Kosovë, që paraqet një disavantazh të panevojshëm krahasuar me operatorët lokalë. Kjo kufizon konkurrencën dhe rrit çmimin e ofertave

AK-ja duhet të korrigojë kërkesën për pronësinë dhe lokacionin e pajisjeve gjatë fazës së vlerësimit. Si zgjidhje, rekomandohet që verifikimi fizik i pajisjeve të bëhet vetëm pas përzgjedhjes së fituesit. Ky ndryshim do të:

Rrisë konkurrencën duke lehtësuar pjesëmarrjen e operatorëve të huaj dhe atyre që marrin pajisjet me qira.

Ulë kostot dhe komplikimet e panevojshme për operatorët ekonomikë.

Pretendimi i tretë: Standardet e emetimit të gazrave (Euro 6, Euro 4, Euro 3)

Kërkesa për standarde të caktuara të emetimit të gazrave si Euro 6, Euro 4, dhe Euro 3 është parë si kufizuese dhe jo proporcionale nga ankuesi.

Eksperti shqyrtues sqaron se Ligji për Automjete Nr. 05/L-132 në Kosovë lejon përdorimin e automjeteve të regjistruara që kalojnë kontrollet teknike periodike, pavarësisht standardeve të emetimit. Për më tepër, neni 7 i LPP-së kërkon që AK të eliminojë praktikatat që kufizojnë konkurrencën ose favorizojnë një grup të OE-ve. Kërkesa për standarde specifike të emetimit të gazrave mund të zvogëlojë pjesëmarrjen dhe të rrisë kostot për OE-të që përdorin automjete të rregullta dhe të regjistruara ligjërisht.

Standardet e emetimit të gazrave, si Euro 6, Euro 4, dhe Euro 3, janë standarde ndërkombëtare që përcaktojnë kufijtë maksimalë të emetimeve të ndotësve nga automjetet motorike si masë për mbrojtjen e mjedisit dhe integritet të praktikave të qëndrueshme. Këto standarde kanë rëndësi për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik, por aplikimi i tyre në kontekste specifike, siç është një kontratë për shërbime, duhet të vlerësohet me kujdes për të shmangur kufizimin e padrejtë të konkurrencës. AK duhet të rishikojë këtë kërkesë dhe të lejojë përdorimin e automjeteve të regjistruara dhe të lejuara nga ligji për të siguruar konkurrencë dhe drejtësi në procesin e tenderimit.

Kërkesat për standarde specifike të emetimit mund të përjashtojnë operatorë ekonomikë me kapacitete financiare të kufizuara. Automjetet që plotësojnë standarde të larta zakonisht kërkojnë investime të konsiderueshme. Kufizimi i pjesëmarrësve në tenderë ul konkurrencën dhe mund të çojë në kosto më të larta për autoritetin kontraktues. Ligji për Automjete në Kosovë garanton që automjetet e regjistruara dhe që kalojnë kontrollet teknike janë të autorizuara për të operuar, duke e bërë kërkesën për standarde shtesë të panevojshme. AK-ja duhet të rishikojë kërkesën për standarde specifike dhe të lejojë pjesëmarrjen e automjeteve që janë të regjistruara dhe kalojnë kontrollet teknike sipas ligjit.

## PËRFUNDIMI

Në pajtim me LPP-në, Rregulloren Nr. 001/2022 dhe Udhëzuesin Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, Autoritetet Kontraktuese duhet të përcaktojnë kriteret e vlerësimit duke garantuar transparencën, mos-diskriminimin dhe trajtimin e barabartë, si dhe një nivel të përshtatshëm

konkurrence. Kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë të arsyeshme dhe të mjaftueshme në raport me vlerën e kontratës dhe përdorimin e drejtë të fondeve publike, duke përfshirë OE të themeluar rishtazi që plotësojnë këto standarde. AK duhet të ketë parasysh se kërkesat e panevojshme jo vetëm që janë të vështira për tu përmbushur, por gjithashtu rrisin kostot për OE, të cilat më pas transferohen te AK përmes çmimit të tenderit.

Për të siguruar një proces të drejtë dhe në përputhje me legjislacionin, rekomandohet që AK-ja të korrigjojë dosjen e tenderit për të adresuar mosmarrëveshjet në përputhje me nenin 7 dhe nenin 69.4.5 të LPP-së dhe të shtyjë afatin për ofertim sipas nenit 53.7 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues rekomandon se ankesa konsiderohet e bazuar dhe rekomandohet që AK-ja:

Të eliminojë kërkesat që reduktojnë në mënyrë të padrejtë konkurrencën ose favorizojnë OE-të specifike.

Të përfshijë mekanizma të tjerë të sigurisë kontraktuale si garancitë financiare dhe verifikimet pas përzgjedhjes së fituesit.

Të sigurojë që çdo kriter i përcaktuar në tender të jetë proporcional dhe i nevojshëm për përmbushjen e kontratës.

Adoptimi i këtyre rekomandimeve do të përmirësojë konkurrencën dhe do të shmangë potencialin për ankesa të ardhshme, duke siguruar një proces të drejtë dhe të paanshëm për të gjitha palët e interesuara.

#### ***- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –***

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovet si e bazuar.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Menaxhimi i mbeturinave” me nr. të prokurimit: 616-24-11988-2-1-1, dhe AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas LPP-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II, III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahim**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - G.S.G SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: